VENDIM
Nr. 610, datë 17.10.2018

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I QENDRËS BAJZË KASTRATI, LOTI I", MALËSI E MADHE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 109/2017, "Për buxhetin e vitit 2018", dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikualifikimi i qendrës Bajzë Kastrati, loti I", Malësi e Madhe.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Malësi e Madhe.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit "truall", "ndërtesë" dhe "njësi shërbimi", me një vlerë të përgjithshme prej 15 312 062 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 15 312 062 (pesëmbëdhjetë milionë e treqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëdhjetë e dy) lekësh, do të përballohet nga llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, do të përballohen nga buxheti i vitit 2018, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.
6. Shpronësimi të fillojë menjëherë.
7. Pronarët, në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, do të kompensohen për efekt shpronësimi pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Malësi e Madhe.
8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe, brenda 30 ditëve, nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Malësi e Madhe, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale si dhe kalimi i pronësisë në favor të shtetit, për pasuritë e shpronësuara.
10. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Malësi e Madhe dhe Bashkia Malësi e Madhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE
TABELA ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT "RIKUALIFIKIMI I QENDRËS BAJZË KASTRATI , LOTI I", MALËSI E MADHE

1. Për truallin, çmimi i llogaritur është marrë nga VKM-ja nr. 89, datë 3.2.2016.
2. Për ndërtimet, vlerësimi është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.8.2000, të ndryshuar, pika 3 dhe sipas çmimeve mesatare të zërave të punës të vënë në dispozicion me shkresën nr. 287 prot., datë 14.2.2017 të EKB-së.

NR	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe trualli që shpronësohet (m²)	Çmimi i truallit (lekë/m²)	Vlera e truallit (lekë)	Sipërfaqe ndërtimi që shpronësohet (m²)	Vlera e ndërtimit (lekë)	Vlera totale trualli + ndërtesë + njësi (lekë)	Shënime
1	Arben Pal Hasaj	3982	2/122	Trualli + ndërtesë	343	231	79,233	210	8,316,650.30	**8,395,883.30**	Konfirmuar "trualli + ndërtesë" nga ZVRPP-ja, me shkresën nr. 8877 prot., datë 30.10.2017. Preventivi i llogaritur sipas sipërfaqes së konfirmuar nga ZVRPP-ja.
2	Ejll Nikoll Keqaj	3982	2/121-ND3	Ndërtesë				114	3,325,143.90	**3,325,143.90**	Konfirmuar "ndërtesë" nga ZVRPP-ja, me shkresën nr. 8877 prot., datë 30.10.2017. Preventivi i llogaritur sipas sipërfaqes së konfirmuar nga ZVRPP-ja.
3	Fran Marash Marinaj	3982	2/121-ND6	Ndërtesë				96	3,089,358	**3,089,358**	Konfirmuar "ndërtesë" nga ZVRPP-ja, me shkresën nr. 8877 prot., datë 30.10.2017. Preventivi i llogaritur sipas sipërfaqes së konfirmuar nga ZVRPP-ja.
4	Fran Zef Malaj Nush Zef Malaj	3982	2/22/ND-N1	Njësi				30	273,642	**273,642**	Konfirmuar "njësi" nga ZVRPP-ja, me shkresën nr. 8877 prot., datë 30.10.2017. Preventivi i llogaritur sipas sipërfaqes së konfirmuar nga ZVRPP-ja.
5	Gjelina Guraj	3982	2/22/ND-N2	Njësi				25	228,035	**228,035**	Konfirmuar "njësi" nga ZVRPP-ja, me shkresë nr. 8877 prot., datë 30.10.2017. Preventivi i llogaritur sipas sipërfaqes së konfirmuar nga ZVRPP-ja.
VLERA TOTALE										**15,312,062**	